



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

14437  
Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 30. 7. 2018

**UDHËZIM**

Fletorja Zyrtare 118

Nr. 28, datë 30. 7. 2018



**MBI KRITERET PËR PJESËMARRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT DREJTUES TË OFRUESVE PUBLIKË TË ARSIMIT E FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 13 pika 4 të ligjit nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Bordi Drejtues i ofruesve publikë të AFP, këtu e në vijim referuar shkurtimisht në këtë udhëzim si “bordi”, ka për qëllim të mbështesë administrimin e drejtimin e institucioneve ofruese të AFP në mënyrë autonome, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe legjislacionin në fuqi.
2. Bordi mbledhet të paktën një herë në tre muaj dhe shqyrton mbi baza tremujore realizimin e planit dhe aspekte të tjera që lidhen me veprimtarinë aktuale dhe të ardhshme të institucionit ofrues të AFP. Bordi duhet të mbledhet domosdoshmërisht para fillimit dhe para përfundimit të vitit shkollor.
3. Bordi shqyrton dhe miraton:
  - a) planin vjetor dhe afatmesëm të veprimtarisë së institucionit ofrues të AFP;
  - b) projekt buxhetin për vitin pasardhës;
  - c) planin vjetor të veprimtarisë së tij;
4. Procedura për ngritjen e bordit dhe zëvendësimin e anëtarëve të cilëve i ka mbaruar mandati ose largohen, kryhet nga drejtori i institucionit ofrues të AFP.
5. Drejtori i kërkon zyrtarisht me shkresë drejtuesve të institucioneve publike përkatëse, të caktojnë përfaqësuesin e tyre në bord.

6. Përfaqësuesit e sektorit privat zgjidhen nga sektorët që lidhen me profilet që kanë numrin më të madh të nxënësve apo praktikantëve ose kanë mbështetur institucionin në ndonjë nga mënyrat. Ato zgjidhen për një periudhë 4 vjeçare, me të drejtë rizgjedhje vetem 1 herë.
7. Ftesa për pjesëmarrje në bord nga përfaqësuesit e biznesit i drejtohet me shkrim shoqërive tregtare dhe organizatave të biznesit që operojnë në rajonin ku ndodhet institucioni ofrues i AFP. Ftesa për pjesëmarrje përmban edhe informacionin e nevojshëm për kushtet, afatet e mënyrën e aplikimit.
8. Kërkesa për pjesëmarrje në bord së bashku me një letër motivimi dorëzohet drejtuesit institucionit ofrues i cili për zgjedh 2 anëtarët që do të përfaqësojnë sektorin privat në bordin e një ofruesi të AFP.
9. Përfaqësuesi i personelit mësimdhënës zgjidhet me votim të fshehtë nga personeli mësimdhënës i institucionit, me shumicë të thjeshtë.
10. Përfaqësuesi i nxënësve zgjidhet nga qeveria e nxënësve ndërsa përfaqësuesi i punëmarrësve nga organizatat përfaqësuese të punëmarrësve.
11. Drejtori i institucionit ofrues të AFP njofton njësinë përgjegjëse për AFP në ministri, në rast se ndesh vështirësi në ngritjen e bordit.
12. Veprimtaria e bordit drejtohet nga kryetari, pozicionin e të cilit e mban përfaqësuesi i sektorit privat profili i të cilit ka numrin më të madh të nxënësve apo kursantëve. Në mungesë të kryetarit, mbledhja e bordit drejtohet nga përfaqësuesi tjetër i sektorit privat.
13. Kryetari i bordit ka këto funksione:
  - a) thërret mbledhjet e bordit;
  - b) ndan detyrat mes anëtarëve të bordit;
  - c) fton në mbledhjet e bordit drejtuesit e institucionit ofrues të AFP, personel të institucionit, përfaqësues të nxënësve e prindërve ose të ftuar të tjerë, sipas rastit;
14. Kryetari i bordit shkarkohet me votim të fshehtë të anëtarëve të bordit, me shumicë të thjeshtë. Votimi për shkarkimin e Kryetarit të bordit zhvillohet nëse kërkohet nga të paktën 3 anëtarë në rast të moskryerjes në mënyrën e duhur të detyrave ose në rast mungesash të vazhdueshme në mbledhje.
15. Mbledhjet e bordit thirren nga kryetari, të paktën 4 anëtarë ose drejtori i institucionit ofrues të AFP. Mbledhjet quhen të vlefshme kur marrin pjesë të paktën 5 anëtarë, përndryshe shtyhen për një datë tjetër të afërt.
16. Vendimet në bord merren me shumicë të thjeshtë votash. Vendimet nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari i bordit.
17. Veprimtaria e bordit asistohet nga sekretari/sekretarja e institucionit të AFP ose një përfaqësues i personelit mësimdhënës, i cili caktohet nga drejtori i institucionit ofrues të AFP.
18. Sekretari i bordit ka këto detyra:

- a) njofton antarët për datën e mbledhjes, axhendën e takimit;
- b) përgatit materialet për mbledhjen;
- c) mban procesverbalin e mbledhjeve;
- d) reflekton vendimet e bordit;
- e) dorëzon në protokollin e institucionit procesverbalet e mbledhjeve e dokumentet e tjera, të cilat arkivohen më pas.

19. Ngarkohen institucionet ofruese të AFP për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi.

*Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

